



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:302090

Datë: 06.03.2024

Numri i dokumentit: 05416769

P.nr. 934/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjyqtarit të vetëm gjykuese Veli Kryeziu, me bashkëpunëtoreshen profesionale Shqipe Latifi, duke vendosur në çështjen penale kundër të pandehurit F... K... nga Gjilani, për shkak të veprës penale, sulmi nga neni 184 paragrafin 1 dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Kodit Penale të Republikës së Kosovës (KPRK-ës), dhe të i pandehurve Sh...B.. dhe L... B..., që të dy nga Gjilani për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1397/2023, të datës 20.12.2023, pas marrëveshjes për ndërmjetësim, me ND.nr.60/2023, të dt. 29.02.2024, më datën 05.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim e arritur në mes të pandehurve F... K..., Sh... B... dhe L...B.... që të gjithë nga Gjilani, në Qendrën në Ndërmjetësimin në Gjilan, më datë 29.02.2024, me numër ND.60/2024 dhe **HUDHET** Aktakuza e Prokurorisë Themelore, Departamenti i Përgjithshëm, me nr.PP.II.nr.1397/2023, e datës 20.12.2023 dhe Pushohet procedura penale kundër të akuzuarve – dëmtuarve, për shkak se ka arritur marrëveshjen nënës tyre.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën me nr. PP.II.nr.1397/2023, të datës 27.12.2023, kundër të pandehurit Fadil Kamberi nga Gjilani, për shkak të veprës penale, sulmi nga neni 184 paragrafin 1 dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Kodit Penale të Republikës së Kosovës (KPRK-ës), dhe të i pandehurve Shkëlqim Baftiu dhe Labinot Baftiu, që të dy nga Gjilani, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës,

Kjo gjykatë, me kërkesën e të akuzuarit dhe të dëmtuarit e ka dërguar lëndën në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjilan.

Më dt. 29.02.2024 në Qendrën për Ndërmjetësim në Gjilan, është arritur marrëveshja për zgjidhjen e kësaj çështje penale përmes ndërmjetësimin në mes të akuzuarve Fadil Kamberi, Shkëlqim Baftiu dhe Labinot Baftiu por në njëjtit janë edhe të dëmtuar.

Qendra për Ndërmjetësim, më dt. 29.02.2024, me Vendimin ND.-nr.60/2024, ka pranuar marrëveshjen e palëve për zgjidhjen e ndërmjetësuar.

Gjykata, duke u bazuar në provat si më lartë, dhe në bazë të nenit 229 paragrafi 4 dhe 6 të KPPRK-së, dhe nenit 12 par.1 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
P.nr. 934/2023, më 05.03.2024

Gjyqtarja i vetëm gjykuese
Veli Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 3 ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.